



Analizë përmbledhëse e rezultateve të anketimit EITI për vitin 2016

Më 13 Shtator, 2016, në fillim të përgatitjes së Strategjisë së Komunikimit EITI 2016 – 2017, Sekretariati Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse zhvilloi të tretin anketim EITI për të matur impaktin që ka EITI në komunitet deri më tani. Ky anketim vjen edhe pas publikimit të Raportit EITI 2013 dhe 2014, i cili përmban informacion koherent mbi zhvillimet e industrisë nxjerrëse si dhe për herë të parë përfshin dhe informacion mbi Hidroenergjinë.

Anketa e tretë EITI u zhvillua në 13 qytete, të cilat janë: Pogradeci, Korça, Bulqiza, Burreli, Librazhdi, Kukësi, Vlora, Patosi, Fieri, Përrenjasi, Rrësheni, Vau i Dejës dhe Tirana dhe për secilin qytet u anketuan 100 qytetarë. Pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar që ju përgjigjën pyetësorit tonë ishin të moshës 18-60 vjeç dhe 55% e tyre ishin të gjinisë mashkullore. 30% e të anketuarve ishin nxënës të shkollave të mesme, 40% staf i administratës lokale, 20% qytetarë të rastësishëm dhe 10% punonjës të kompanive nxjerrëse.

Pyetësi konsistoi në 21 pyetje, për të prodhuar të dhëna se sa njohuri kanë qytetarët e Shqipërisë rreth industrisë nxjerrëse, Nismës EITI dhe investimeve në komunitetin e tyre nga të ardhurat që sjell kjo industri në arkën e buxhetit të shtetit. Anketimi zgjati deri në fillim të Nëntorit 2016 dhe shërbeu edhe si një mjet promovimi i Nismës EITI, ku stafi i Sekretariatit Shqiptar EITI zhvilloi takime me

përfaqësues të të gjitha bashkive ku u fol rreth implementimit të Nismës EITI në Shqipëri, publikimit të raporteve vjetore EITI, si dhe rreth problematikave që hasin këto bashki në mbledhjen e të ardhurave nga renta minerare, etj. Më poshtë gjendet një analizë përmbledhëse e rezultateve të anketimit EITI për vitin 2016.

Pyetëtori



A jeni të interesuar të dini se çfarë ndodh me industrinë nxjerrëse në vend/qytetin tuaj dhe si menaxhohen të ardhurat prej tyre?

88 % e qytetarëve në të gjitha rrethet ku u zhvillua anketa janë përgjigjur Po. Përqindja e lartë tregon interesin e qytetarëve për të pasur informacion rreth burimeve natyrore. Por nga përgjigjet e pyetjeve vijuese vihet re se megjithë interesin e lartë të qytetarëve ka mungesë informacioni rreth aktivitetit të kompanive operuese.



Pronësi e kujt mendoni se janë burimet natyrore të vendit tonë/qytetit tuaj (mund të zgjidhni më shumë se një)?

- A. Pushtetit qendror
- B. Pushtetit lokal
- C. Banoreve te zones ku ka burime natyrore
- D. Pronarit qe ka leje/licence per t'i shfrytezuar e. deputetit te zones
- E. Deputetit të zonës

F. Te gjithëve ne

Rreth 80 % e qytetareve të anketuar përgjigjen se burimet natyrore të vendit tonë i perkasin pushtetit qendror, pronareve që kanë marrë license për të shfrytëzuar apo deputeteve të zonave dhe vetëm 20 % e qytetareve përgjigjen se këto burime natyrore i perkasin banorëve të zonës ku ka burime natyrore. Besimi të qytetarët se kjo industri shfrytëzohet për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të komuniteteve është shumë i ulët.



Çfarë burimesh natyrore ka/shfrytëzohet në Shqipëri/qytetin/zonen tuaj (mund të zgjidhni më shumë se një)?

- A. Krom
 - B. Naftë
 - C. Hidrokarbure
 - D. Qymyrgur
 - E. Tjetër
-

Nga përgjigjet e kësaj pyetje rezultoi se rreth 75 % e qytetareve në secilin prej rrethëve, kanë informacion rreth burimeve natyrore që nxirren në terren ku ata jetojnë.



A i dini emrat e kompanive/operatoreve te industrise nxjerrrese qe operojne ne qytetin/zonen tuaj?

- A. Po , te te gjithëve (permendni disa:
 - B. Jo
 - C. Jo te te gjithëve
-

Shumë prej qytetarëve të anketuar kanë të afërm të cilët punojnë në kompanitë operuese dhe 40% e tyre janë dijeni të emrave të kompanive që operojnë në qytetin e tyre. Ndërsa 60% e qytetarëve nuk kishin dijeni apo informacion në lidhje me emrat e kompanive.



A e dini kush janë pronarët e tyre?

75 % e qytetareve shprehen se nuk e dinë se kush janë pronarët e vërtet të kompanive. Kjo përqindje e lartë tregon edhe njëherë nevojën e bërjes publike dhe transparente të Pronarëve të Vërtet.



À mendoni se pas këtyre kompanive mund të ketë pronarë të fshehur si politikanë, deputet e zonash, zyrtarë të tjerë?

Bazuar edhe mbi sontazhet e ndryshme të kryera nga organizata jo qeveritare rezulton që qytetarër kanë shumë pak besim te mirëqeverisja e pushtetit lokal dhe 65% e të anketuarve u përgjigjën, që po mendojmë që pas këtyre kompanive përfshihen njerëz me pushtet politik dhe burimet përdoren për përfitime personale të njerëzve me pushtet politik.



À besoni se të gjithë punonjësit e kompanive të këtyre industrive janë të siguruar dhe janë të kënaqur me kushtet e punës dhe pagën e tyre?

Rreth 55 % e të anketuarve shprehen që punonjësit janë të siguruar dhe të kënaqur me kushtet e punës. Peshën kryesore të kësaj % e zënë zonat naftës nxjerrëse dhe vihet re që kjo industri ka bërë hapa përpara drejt përmirësimit të kushteve të punës dhe të qënurit konfort ligjit në fuqi që rregullon marrënit e punës.



À mendoni (ose dini) se këto kompani shfrytëzojnë minorenë në punë?

Rreth 68 % e te anketuarve i përgjigjen Jo kesaj pyetje. 32% e të anketuarve përgjigjen se për arsye ekonomike, minorenëve i lejohet punësimi në këto kompani por kundrejt disa kushteve specifike si përshëmbull kushtet e punës dhe oraret e reduktuara të punës.



Kush mendoni se përfiton nga pagesat/të ardhurat që vijnë nga industria nxjerrëse (mund të zgjidhni më shumë se një)?

- A. Pushteti qendror/qeveria
 - B. Pushteti lokal/ bashkite
 - C. Banoret e zones/qytetit ku ka veprimtari te industrise nxjerrese
 - D. Pronaret e kompanive
 - E. Pushtetare/Njerez ne politike
-

Besimi të qytetarët se kjo industri shfrytëzohet për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të komuniteteve është shumë i ulët. Rreth 67 % e të anketuarve pergjigjen se perfitues te pagesave apo te ardhurave qe vine nga industria nxjerrese jane qeveria, pronaret e kompanive dhe pushtetaret, vetem 33 % e të anketuarve pergjigjen se keto te ardhura i shkojne pushtetit lokal dhe askush nuk pergjigjet se perfitimet nga keto ardhura shkojne per banoret e zones, komunitetin.



A jeni në dijeni të ndonjë investimi publik të bërë në qytetin/zonën tuaj (nga pushteti lokal), si rrjedhojë e të ardhurave prej veprimtarisë nxjerrëse në qytetin/zonën tuaj?

Rreth 75% e të anketuarve nuk janë në dijeni të ndonjë investimi publik të bërë nga të ardhurat e veprimtarive nxjerrëse në qytetin e tyre. Anketa tregon se shqetësimet e qytetarëve, më së shumti kanë të bëjnë me zhvillimin e dobët ekonomik dhe papunësinë e lartë. Por nga këto rezultate del se 25% e të anketuarve mendojnë se punimet që po bëhen në zhvillimin e qendrave të qyteteve të Shqipërisë po financohen nga të ardhurat që fitohen nga industria nxjerrëse.



A jeni në dijeni të ndonjë aktiviteti që sponsorizohet nga operatorët e industrisë nxjerrëse në zonën tuaj?

Nga të anketuarit rezulton se 78% e tyre nuk kanë informacion të ndonjë aktiviteti të sponsorizuar nga industritë nxjerrëse. Kjo përqindje është tregues i rëndësishëm i mos përfshirjes së kompanive nxjerrëse në aktivitet sociale të komunitetit ku ato shtrijnë veprimtarinë e tyre.



À mendoini se kompanitë e industrisë nxjerrëse kanë shkaktuar apo shkaktojnë ndotje të mjedisit në zonën tuaj apo deme te tjera?

55% e të anketuarve në zonat minerare nuk mendojnë se kompanitë nxjerrëse shkaktojnë ndotje të mjedisit por e kundërta ndodh në zonat naftë nxjerrëse ku 70% e të anketuarve mendojnë se kompanitë nxjerrëse shkaktojnë ndotje të mjedisit nga mbetjet e naftës.



A jeni në dijeni se sa të ardhura gjenerojnë këto kompani nga aktiviteti që kryejnë?

80% e qytetarëve të anketuar nuk janë në dijeni të të ardhurave të gjeneruara nga kompanitë nxjerrëse. Ky tregues na informon ne mbi shkallën e ulët të transparencës të kompanive që operojnë në këto zona ose thjesht neglizhencën e kompanive për ta informuar qytetarin.



EITI Albania është Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Keni dëgjuar ndonjëherë për të?

78% e të anketuarve nuk kanë dëgjuar asnjëherë për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Të anketuarit në Bashkitë e qyteteve përbënin atë përqindje të qytetarëve që kishin dëgjuar të paktën një herë për nismën dhe misionin e EITI.



Nëse po, ku keni dëgjuar/lexuar për të (mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)?

- A. Ne TV
- B. Ne radio
- C. Ne shtyp elektronik
- D. Reklame ne rruge
- E. Nga nje mik
- F. Ne nje seminar te organizuar nga EITI Albania

Të anketuarit në Bashkitë e qyteteve kanë dëgjuar për Nismën EITI nga seminarët e organizuara nga Sekretariati Shqiptar EITI me administratën e bashkive.



Për çfarë mendoni se shërben aktiviteti/prezenca e EITI Albania? (Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

- A. Per te bere transparence në menaxhimin e burimeve natyrore
- B. Per te bere transparencë në pagesa dhe të ardhura nga këto industri
- C. Per te parandaluar korrupsionin †
- D. Per te rritur besueshmerin e publikut
- E. Per te mbrojtur mjedisin nga ndotjet e industries nxjerrese
- F. Nuk e di
- G. Tjetër

Pyetjeve “Për të bërë transparencë në menaxhimin e burimeve natyrore” dhe “Për të bërë transparencë në pagesa dhe të ardhura nga këto idustri” ju përgjigjën 65 % e të anketuarve. 20% u përgjigjën se EITI shërben për të mbrojtur mjedisin nga ndotjet e industrisë nxjerrëse dhe 15 % u përgjigjën se Nisma EITI është një organizëm në parandalimin e korrupsionit.



A keni dëgjuar
ndonjëherë për
raportet që përgafit
EITI Albania?

Vetëm të anketuarit në Bashkitë e qyteteve kanë dëgjuar dhe parë të paktën një Raport EITI, kjo si rrjedhojë e seminareve të organizuara nga Sekretariati Shqiptar EITI me administratën e bashkive.



Nëse po, a mendoni se
janë të domosdoshme dhe
informues mjaftueshëm për
të kuptuar gjithçka mbi
menaxhimin dhe
transparencën e industrisë
nxjerrëse?

Duke u nisur nga numri i lartë i qytetarëve që nuk kanë dëgjuar apo parë të paktën një Raport EITI, 82% e të anketuarve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje.



Nëse Jo, çfarë mendoni
se duhet të shtohet në
këto raporte? Pra çfarë
do të donit të dinit më
shumë mbi industritë
nxjerrëse dhe kompanitë
që operojnë në treg?

Duke u nisur nga numri i lartë i qytetarëve që nuk kanë dëgjuar apo parë të paktën një Raport EITI, 75% e të anketuarve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje.



À mendoni se keni nevojë të informoheni më shpesh dhe të dini më shumë mbi industrinë nxjerrëse të zonës tuaj dhe kompanive që i menaxhojnë ato?

77% e të anketuarve u shprehën pozitiv për tu informuar mbi industrinë nxjerrëse dhe për kompanitë që i menaxhojnë ato.



Nëse po, nga cili kanal komunikimi do të donit të informoheni (mund të zgjidhni më shumë se një)

- A. Duke u regjistruar ne buletin informativ periodik qe vjen me e-mail
- B. Nga TV kombetare
- C. Nga TV lokale
- D. Nga website i EITI Albania
- E. Nga shtypi elektronik
- F. Nga shtypi i shkruar tradicional (gazeta, revista)
- G. Nga facebook
- GJ. Nga LinkedIn
- H. Nga reklama outdoor (postera, CTL, wallbanners) ne qytetin ku banoj

65% e të anketuarve të moshës 30-55 kanë zgjedhur televizionet kombëtare për tu informuar dhe 70% e të anketuarve të moshës 18- 30 kanë zgjedhur facebook për tu informuar mbi industrinë nxjerrëse.